# DËSHMI ARKIVI

**A-451910**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Alarm në Gjermani, “plas” malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/alarm-ne-gjermani-plas-malaria-e-aeroportit-8-te-prekur-e-dy--ne-fra-i586661` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 10:53:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 11:10:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1fc7c7a622dd79513bd57587b61885428ef8509bde724b3840417b0b90d59f5c` |
| TEKSTI | `0e41c6d72ac0e4da86842d8854687d930bbfa6aa679028c2ae64338a6069debc` |
| PAMJA | `37b631e8af382baafbeaf25157c71a7a12750b6a17be4ee84fd23285e08be310` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f7d8f7ed635060bf917a237818e517660965e7bd65a6af72dca42c4dce3bcc45` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f7d8f7ed635060bf917a237818e517660965e7bd65a6af72dca42c4dce3bcc45`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Alarm në Gjermani, “plas” malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt

TemA
17 Shtator 2026, 13:10Bota TEMA




Autoritetet shëndetësore në Gjermani janë vënë në alarm pas një shpërthimi të rasteve të malaries në Frankfurt, një sëmundje kjo që në Europën Perëndimore mendohej se kishte mbetur pjesë e së shkuarës.

Që nga korriku, në këtë qytet janë konfirmuar tetë raste të saj, ndërsa dy persona kanë vdekur. Dy infektimet e fundit u identifikuan në Schwanheim, një zonë që ndodhet pranë aeroportit të Frankfurtit.

Autoritetet po hetojnë nëse ekziston ndonjë lidhje mes rasteve dhe aeroportit, pasi disa nga personat e infektuar kanë qenë punonjës të tij. Një nga mundësitë që po shqyrtohet është mbërritja e mushkonjave të infektuara me avionë nga vende ku malaria është e përhapur. Nëse këto mushkonja mbijetojnë dhe pickojnë persona të tjerë, ato mund ta transmetojnë parazitin që shkakton sëmundjen. Ky fenomen njihet si “malaria e aeroportit”.

Malaria është një sëmundje infektive që transmetohet kryesisht përmes pickimit të mushkonjave të infektuara. Në fazat e para, simptomat mund të ngatërrohen me gripin ose me një infeksion të traktit gastrointestinal.

Simptomat më të zakonshme përfshijnë temperaturën e lartë, të dridhurat, dhimbjet e kokës dhe të trupit, si dhe shqetësimet gastrointestinale. Forma më e rëndë, malaria tropica, mund të jetë fatale nëse nuk diagnostikohet dhe trajtohet në kohë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kryeministri kanadez mban fjalim në Parlamentin Evropian: Evropa dhe Kanadaja janë më të forta së bashku]

12:40 Bota / 2 komente

E rëndë në Itali/ Ministri i Arsimit merr zarfin kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Këto akte frikacake nuk kanë vend në demokraci

12:20 Bota / 1 koment

Studiuesit: Ndryshimet klimatike çuan në katastrofën e shembjes së malit në Nepal

11:50 Bota

Trump: Irani kontaktoi drejtpërdrejt SHBA-në, dëshiron të arrijë një marrëveshje

10:50 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.